

DR. EDUART CAKA

Instituti i Historisë / Akademia e Shkencave e Shqipërisë
edicaka@hotmail.com

**MBI PËRBËRJEN ETNIKO-FETARE TË HAPËSIRAVE
JUGORE SHQIPTARE GJATË SHEK. XV
SIPAS REGJISTRAVE KADASTRORË OSMANË
TË KËSAJ PERIUDHE. NJË RILEXIM****Abstrakt:**

Shtrirja e sundimit osman në hapësirën ballkanike gjatë shek. XV solli me vete edhe ndryshime në aspektin politik, ekonomik dhe kulturor të kësaj hapësire. Kështu, përveç një pjese të vogël të zonave bregdetare që vijuan të qëndronin nën sundimin venecian, në brendësinë e gadishullit u shtri plotësisht sundimi i sulltanit, i cili në praktikë u zbatua kryesisht përmes instalimit të sistemit të timarit. Për rrjedhojë, regjistrat kadastrorë, të cilët janë edhe burimet kryesore që i referohen funksionimit të këtij sistemi, përbëjnë edhe dokumentacionin parësor sa i përket historisë së zotërimeve osmane për këtë shekull. Ndonëse qëllimi i hartimit të tyre lidhej drejtpërdrejt me politikën fiskale që osmanët ndërmorën në hapësirat ku shtrinë sundimin e tyre, regjistrat kadastrorë mbeten burimet kryesore për të kuptuar historinë lokale të shek. XV. Në këtë artikull synohet një lexim analitik i këtyre burimeve për të evidentuar rolin që ato luajnë në gjurmimin e pranisë së shqiptarëve, veçanërisht në hapësirat jugore gjatë kësaj periudhe.

Fjalë kyç:

Demografi, etnicitet, religjion, regjistra kadastrorë osmanë, shek. XV.

Hyrje

Ekzistojnë pikëpamje dhe qasje të ndryshme në lidhje me praninë dhe shtrirjen e shqiptarëve në pjesën jugore të hapësirave tokësore të banuara prej tyre, një gjeografi të cilën sot e gjejmë të pozicionuar brenda

hartave politike të Shqipërisë dhe Greqisë. Një temë që ka dalë shumë herë jashtë kornizave të debatit historik, duke u kthyer më së shumti në çështje debatesh politike ndërmjet aktorëve të ndryshëm. Do të ishte jashtë mundësive të këtij artikulli të trajtonim në mënyrë të detajuar një tematikë kaq komplekse të shtrirë në një hapësirë të gjatë disashekullore. Për këtë arsye, u mjaftuam vetëm me të dhënat që ofrojnë defterët kadastrorë osmanë të shek. XV, të cilët na mundësuan të vizatojmë një kornizë identifikuese të pjesës jugore të hapësirave të banuara nga shqiptarët në atë kohë.

Arsyeja e shfrytëzimit të regjistrave kadastrorë osmanë (*Tahrir Defterleri*) lidhet pikësepari me faktin se këto burime paraqesin një numërim të plotë dhe të saktë të popullatës në hapësirat në të cilat qe shtrirë sundimi osman, ku në bazë të të dhënave statistikore shteti nxirrte edhe zërat taksorë që vilte prej banorëve vendës. Megjithatë, vlen të theksohet se të dhënat e këtyre burimeve lidheshin ngushtësisht me zonat e marra në regjistrim dhe, veçanërisht gjatë periudhës së hershme, shumë vendbanime nuk figurojnë të përfshira. Për më tepër, dhe ndoshta edhe më e rëndësishmja që duhet pasur parasysh, është fakti se qëllimi parësor i hartimit të këtyre defterëve lidhej me vjeljen e taksave. Pra, ndonëse këta regjistra përpiloheshin kryesisht me qëllime fiskale, ata përmbajnë gjithashtu detaje të rëndësishme edhe në aspektin demografik, urbanistik, fetar, kulturor dhe etnik të hapësirave që përfshijnë. Nga ky këndvështrim, tekstet në fjalë kanë një peshë të konsiderueshme në historishkrimin e periudhës së cilës i përkasin, por duhet të përdoren duke u krahasuar me burime të tjera bashkëkohore dhe të shfrytëzohen sipas një metodologjie të caktuar. Pikërisht këto të dhëna të rëndësishme e bëjnë defterologjinë një kategori të veçantë brenda fushës së studimeve osmane.¹

Në këtë artikull do të bazohemi kryesisht tek tre defterë që i përkasin shek. XV, përkatësisht: ai i sanxhakut të Arvanidit (1431-32),²

¹ Për më shumë detaje mbi defterologjinë si lëmi pune, si dhe mbi përdorimin e të dhënave të regjistrave kadastrorë në studimet demografike, shih: Heath W. Lowry, *Studies in Defterology: Ottoman Society in the Fifteenth and Sixteenth Centuries* (Istanbul: The Isis Press, 1992), 10-13. Gjithashtu, shih John C. Alexander, "Counting the Grains: Conceptual and Methodological Issues in Reading the Ottoman Mufassal Tahrir Defters", *Arab Historical review for Ottoman Studies*, no. 19-20 (1999): 55-69.

² *Hicri 835 Tarihli Sûret-i defter-i sancak-i Arvanid*, Neşr. Halil İnalçık (Ankara: Türk Tarih Kurumu Basımevi, 1954). Për përkthimin në gjuhën shqipe të këtij

regjistri i Përmetit dhe Korçës (1431-32),³ si dhe ai për sanxhakun e Tërhallës (1454-55).⁴ Dy të parët janë të llojit të përmbledhur (*Ixhmal*), ndërsa i treti është i hollësishëm (*Mufassal*), duke përmbajtur kështu edhe kryefamiljarët e vendeve të përfshira në regjistrim. Të tria burimet përputhen me njëra-tjetrën, madje janë edhe komplementare, si në kohë ashtu edhe në hapësirë. Ato i përkasin gjysmës së parë të shek. XV në aspektin kronologjik, ndërsa në atë hapësinor dhe gjeografik, defteri i sanxhakut të Tërhallës duket se është një zgjatim apo vazhdimësi e zonave të regjistruara në defterët e Arvanidit dhe atij për Përmetin e Korçën. Vilajeti i Vagenetisë,⁵ pjesë e defterit të parë, si dhe zonat si Konica me Kosturin e Grevenën, të përfshira në të dytin,⁶ pozicionohen në kufijtë veriorë të sanxhakut të Tërhallës.

Fillimisht duhet theksuar se, në lidhje me studime të këtij karakteri, ekzistojnë disa problematika që e vështirësojnë punën e historianit. E para ka të bëjë me numrin e kufizuar të burimeve që datojnë në këtë periudhë. Më konkretisht, sa i përket dokumentacionit osman, defterët e përmendur më sipër janë edhe dokumentet e para të plota që na japin një tablo të saktë statistikore mbi vendbanimet në këto hapësira, si dhe mbi numrin e banorëve dhe emrat e kryefamiljarëve, siç dëshmohet në rastin e defterit të Tërhallës.

Si pasojë e mungesës së burimeve të mëhershme mbi aspektin demografik të kësaj hapësire, edhe numri i studimeve mbi këtë çështje ka qenë i kufizuar dhe kryesisht i përqendruar te periudha e sundimit osman.⁷ Kjo shpjegohet me faktin se, sikurse u përmend më lart,

regjistri, shih: *Regjistri i Sanxhakut të Arvanidit i vitit 1431*, përgatitur për botim nga Halil Inalcık, përkthyer nga Mykerem Janina, përkthimi i hyrjes dhe përgatitja për botim në shqip nga Eduart Caka, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë (Tiranë: Kristalina-KH, 2017).

³ *Defteri i regjistrimit të Përmetit dhe Korçës i vitit 1431*, përkthyer nga Vexhi Buharaja, përgatiti për botim Eduart Caka, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë (Tiranë: Kristalina-KH, 2018).

⁴ *Hicrî 859 Tarihli Sûret-i Defter-i Sancak-ı Tırhala*, C. I-II, neşr. Melek Delilbaşı, Muzaffer Arıkan (Ankara: Türk Tarih Kurumu Basımevi, 2001).

⁵ *Regjistri i sanxhakut të Arvanidit*, 5-6.

⁶ *Defteri i regjistrimit të Përmetit dhe Korçës*, 94, 128. Gjithashtu, shih: Eduart Caka, “Regjistri kadastral i Përmetit dhe i Korçës si burim të dhënash mbi gjendjen e Shqipërisë Juglindore në gjysmën e parë të shek. XV”, *Studime historike*, nr. 1-2 (2018): 55-71.

⁷ Për shembuj të studimeve të tilla, shih: Ferit Duka, “Realiteti etnik i Dropullit në burimet historike të shek. XVI. (Defteri osman i regjistrimit të pronave dhe të

regjistrimet e para të plota i përkasin kësaj periudhe, por jo vetëm. Sipas Kiel-it, periudha e sundimit osman në hapësirën greke, e cila në historiografinë vendëse njihet edhe si *Tourkokratia*, është interpretuar për një kohë të gjatë si një periudhë e shkretimit demografik, urbanistik e ekonomik të vendit; një qasje e tillë ka kushtëzuar gjithashtu edhe hulumtimin e regjistrave kadastrorë.⁸ Megjithëse gjatë dekadave të fundit janë shtuar studimet shkencore në këtë drejtim, kryesisht të realizuara nga historianë turq dhe grekë,⁹ rishqyrtimi i këtyre regjistrave për këtë hapësirë, si dhe analiza e aspekteve të antroponimisë dhe toponimisë – pra e onomastikës në tërësi – ofron disa rezultate që kanë munguar në studimet e kryera deri më tani.

Problemet historike, burimore e metodologjike

Ekzistojnë disa problematika që e vështirësojnë ndërmarrjen e një studimi të bazuar mbi evidencat e karakterit etnik kur flasim për shek. XV, për shkak se nocioni i etnisë dhe i kombit në këtë periudhë ishte krejtësisht i ndryshëm nga kuptimi që këta terma fituan në shekujt e mëvonshëm, veçanërisht pas krijimit të shtetit modern. Ky element evidentohet qartë edhe nga Gellner-i në analizën e tij mbi revolucionin grek, kur shprehet se:

popullsisë të sanxhakut të Vlorës i vitit 1520)”, *Studime historike*, nr. 3-4 (1991): 167-199; Evangelia Balta, Mustafa Oğuz, Filiz Yaşar, “The Ethnic and Religious Composition of Ottoman Thesprotia in the Fifteenth to Seventeenth Centuries”, *Thesprotia Expedition II: Environment and Settlement Patterns*, ed. Björn Forsén, Esko Tikkala, (Helsinki: Suomen Ateenan-Instituutin Säätiö, 2011), 347-389.

⁸ Për më shumë në lidhje me këtë çështje, shih: Machiel Kiel, “Central Greece in the Suleymanic Age. Preliminary Notes on Population Growth, Economic Expansion and its Influence on the Spread of Greek Christian Culture”, *Soliman le Magnifique et Son Temps. Acts du Colloque de Paris*, Ed. Gilles Veinstein (Paris: La Documentation Française, 1992), 399-424.

⁹ Këtu mund të veçojmë studimet e bizantinologes turke Melek Delilbaşı, e cila ka përgatitur për botim regjistrin e hollësishëm të sanxhakut të Tërhallës për vitin 1454-1455, të cilit i jemi referuar në këtë artikull. Për studime të tjera të së njëjtës historiane mbi hapësirën në fjalë, shih: Melek Delilbaşı, *İki İmparatorluk Tek Coğrafya: Bizans'tan Osmanlı'ya Geçişin Anadolu ve Balkanlar'daki İzleri* (İstanbul: İthaki, 2013); Melek Delilbaşı, “A Contribution to the History of Epirus (XVth-XVIth Centuries)”, *GAMER*, vol. I, no. 1 (2012): 37-60; Melek Delilbaşı, “History of Preveza in the XVth Century According to the Ottoman Taxation Registers”, *OTAM*, vol. 2, no. 2 (1991): 53-61.

“Me të vërtetë, ka arsye për të dyshuar që lëvizja kombëtare fillestare greke nuk synonte një shtet-komb modern homogjen, porse një përmbysje rangjesh brenda Perandorisë së atëhershme: shkurt, ta kthente sahatin mbrapa dhe ta zëvendësonte Perandorinë Osmane me një Bizant të ri”.¹⁰

Vlen të theksohet se është tepër e vështirë, madje edhe e pamundur, të përcaktohet me saktësi përbërja etnike e zonave të kësaj hapësire, ashtu si edhe e rajoneve të tjera të Ballkanit që hynë nën administrimin osman në fund të shek. XIV dhe në fillim të shek. XV. Kjo lidhet me dy arsye kryesore: *së pari*, në aspektin administrativ, këto hapësira ishin të inkuadruara brenda Perandorisë Bizantine; *së dyti*, në mentalitetin e kohës, identiteti fetar prevalonte mbi atë etnik. Po ashtu, organizimi shoqëror i sunduesit të ri, në rastin konkret atij osman, konsistonte në ndarjen e popullatës sipas përkatësisë fetare. Këtë ndarje e gjejmë të strukturuar nën nocionin e *sistemit të mileteve*,¹¹ i cili u zbatua deri në gjysmën e parë të shek. XIX përmes organizimit konfesional, ku komunitetet e besimeve monoteiste funksionuan brenda Perandorisë Osmane. Për këtë arsye, duke u bazuar në burimet e kohës, është tejet e vështirë të mësojmë për një zonë, qytezë apo fshat, e aq më tepër për individë, lidhur me përkatësinë e tyre etnike, përveç rasteve kur ky element transmetohet nga ndonjë autor apo dokument i kohës.

Për rrjedhojë, dokumentacioni i kohës nuk ndalet tek elementi etnik i individëve që ishin subjekt i hartimit të regjistrave, procedurave juridike apo shkresave të çdo lloji. Veçanërisht gjatë periudhës së hershme të vendosjes së osmanëve në këtë gjeografi, kur kancelaria osmane nuk ishte ende e zhvilluar plotësisht dhe korpusi i dokumenteve ishte më i kufizuar,¹² panorama e plotë e vendbanimeve dhe e popullsisë – përfshirë

¹⁰ Ernest Gellner, *Nacionalizmi*, përktheu Bashkim Shehu (Tiranë: Botimet IDK, 2008), 57.

¹¹ M. O. H. Ursinus, *The Encyclopaedia of Islam*, New Edition, Ed. C. E. Bosworth, E. Van Donzel, W. P. Heinrichs, Ch. Pellat, vol. VII (Leiden: E. J. Brill, 1993), 61-64; İlber Ortaylı, “Millet: Osmanlılar’da Millet Sistemi”, *TDV İslam Ansiklopedisi*, C. XXX (Ankara: TDV Yay., 2020), 66-70.

¹² Gjatë periudhës së hershme të shtetit osman, që fillon me themelimin e principatës së Osmanit në fillim të shek. XIV dhe shtrihet deri në pushtimin e Stambollit, lloji i dokumentacionit që dilte nga kancelaria osmane dhe që i ka rezistuar kohës deri në ditët tona është mjaft i kufizuar. Për këtë arsye, regjistrat kadastrorë, më i hershmi ndër ta, ai i vitit 1431 për Shqipërinë, konsiderohen si burimet më të vjetra osmane. Krahas

këtu edhe përbërjen etnike dhe religjioze – mbetet e vështirë për t'u kuptuar.

Ndonëse burimet e lartpërmendura nuk kanë pasur për qëllim përcaktimin e elementit etnik, historiografia moderne ka tentuar të hedhë dritë në këtë drejtim, duke u përpjekur që përmes emrave të njerëzve apo vendeve të identifikojë përkatësinë etnike. Mirëpo, në këtë rast, mosnjohja e gjuhëve lokale nga studiuesit e fushës ka bërë që, edhe nëse leximet e defterëve të jenë teknikisht të sakta, ato mund të çojnë në përfundime të gabuara kur flitet për elementet etnike. Fjala vjen, emri Bardis (باردس) nga *Mahalle-i Arnavudan* (Lagja e Shqiptarëve) e Tërhallës¹³ tingëllon pa kuptim për një lexues që nuk e njeh gjuhën shqipe, por merr kuptim të plotë vetëm nëse shfrytëzuesi i regjistrit e kupton këtë gjuhë. Në rastin konkret, nëse nuk do të ishte etiketuar përkatësia e lagjes, as emri i lartpërmendur nuk do të dallohej qartësisht në kontekstin etnik. Për ta ilustruar, mjafton të shohim fshatin Ginlalsi (کین لالشی) ku, në mungesë të njohjes së gjuhës shqipe, emri *Gjin* bëhet i padallueshëm.¹⁴

Një panoramë e ngjashme nuk haset vetëm në pjesën e Tërhallës apo në hapësirën që kemi marrë në shqyrtim në këtë artikull, por edhe në rajonet veriore ku banonte popullsia shqiptare në prag të vendosjes së sundimit osman. Më konkretisht, kur emra si Jorgo, Mihal, Dhimitër, Johan etj., i referohen kryesisht përkatësisë fetare dhe nuk japin asnjë tregues për përkatësinë etnike të personit të regjistruar, studiuesi e ka të pamundur të arrijë në përfundime të qarta. Një shembull i tillë gjendet në aktet e kancelarisë raguzane të vitit 1427, në një rast të evidentuar nga Schmitt-i, ku për një person të quajtur Bogdan Petroviç jepet një informacion sqarues, që identifikohet si *Albanensis de Budua*, pra “shqiptar i Budvës”.¹⁵ Një shembull i dytë haset për një shërbyes me

tyre mund të përmenden edhe kronikat, si dhe defterët e vakëfeve (Evkaf Defterleri). Pikërisht për këtë arsye, veçanërisht në studimin e vendbanimeve, është me rëndësi që regjistrat kadastrorë të shfrytëzohen duke u krahasuar edhe me defterët e vakëfeve. Për më shumë në lidhje me këtë temë, shih: H. Lowry, *Studies in Defterology*, 8-9.

¹³ *Defter-i Sancak-i Tirhala*, C. I, 7.

¹⁴ *Po aty*, 197.

¹⁵ Oliver Jens Schmitt, *Arbëria Venedike (1392-1479)*, përkthyer nga Ardian Klosi (Tiranë: Fjala Publishing, 2014), 54.

origjinë shqiptare pranë një fisniku në Raguzë, ku në një proces gjyqësor flitet për *Petrus albanensis*, pra “Pjetër shqiptarin”.¹⁶

Pikërisht si rrjedhojë e problemeve të parashtruara më sipër, lind nevoja për një rilexim të dokumentacionit arkivor dhe për një riinterpretim të të dhënave, një proces i cili, në rastin e studimit të regjistrave kadastrorë osmanë, lipset të kryhet sipas një metodologjie të caktuar. Edhe kjo nuk do të ofronte një tablo plotësisht të qartë, por ndihmon në vendosjen e disa piketave hapësinore dhe demografike mbi prezencën e shqiptarëve në territoret e përfshira brenda regjistrimeve që mbartin këta defterë.

Para se t’i analizojmë më nga afër burimet e shqyrtuara, është e nevojshme të parashtrohen dy çështje me karakter historik që lidhen me prezencën e shqiptarëve në hapësirat jugore. *E para* ka të bëjë me emigrimet drejt Jugut gjatë shek. XIV, si pasojë e pushtimeve të ndërmarra nga serbët gjatë sundimit të Stefan Dushanit; ndërsa *e dyta* lidhet me konfigurimin politiko-ushtarak dhe demografik të kësaj hapësire gjatë inkursioneve osmane dhe vendosjes së plotë të sundimit të sulltanit në këtë zonë.

Emigrimet e shqiptarëve gjatë shek. XIV drejt hapësirave jugore

Emigrimi i grupeve të mëdha të njerëzve për shkak të luftërave drejt hapësirave më sigurta është një dukuri e shpeshtë në historinë e popujve të ndryshëm, veçanërisht në Ballkan – gjeografi e cila ka qenë vazhdimisht një hapësirë tranziti për ushtritë që marshonin nga Perëndimi drejt Lindjes e anasjelltas, si dhe si skenë e rivaliteteve ndërmjet mbretërive dhe perandorive që synonin të vendoseshin në rajon. Një shembull ilustrues është qyteti i Durrësit, i cili, sipas M. Shuflajt, kishte ndryshuar zotërim plot 31 herë brenda 400 vjetëve (992-1392).¹⁷

Dobësimi politik dhe ushtarak i Bizantit shkaktoi luhatje në rendin dhe sigurinë e hapësirave lindore të kësaj perandorie, ku përfshiheshin

¹⁶ *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shekullit XV*, vëll. III (1411-1415), transkriptimi dhe përkthimi nga Injac Zamputi, Përparime Huta, redaktimi dhe përgatitja për botim nga Edmond Malaj, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë (Tiranë: Botimet albanologjike, 2018), 697.

¹⁷ Milan Shuflaj, *Qytetet dhe kështjellat e Shqipërisë, kryesisht në mesjetë*, përgatiti për botim Luan Malltezi (Tiranë: Onufri, 2009), 9.

edhe hapësirat shqiptare, të cilat u shndërruan në arenë zhvillimesh të dendura politike dhe ushtarake, veçanërisht gjatë shek. XIII-XV. Me këtë nënkuptojmë tkurrjen e sundimit bizantin, ekspansionin e Mbretërisë Serbe, si dhe përplasjet ndërmjet fisnikërisë shqiptare për dominim pas tërheqjes së serbëve nga këto territore. Sigurisht, mungesa e stabilitetit politik dhe ekonomik i detyronte banorët lokalë të braktisnin vendbanimet e tyre dhe të vendoseshin në zona më të sigurta, pra të emigrinin.

Sigurisht, për ta përmbledhur gjithë këtë lëvizshmëri demografike vetëm me termin emigrim, do të ishte e pasaktë. Kjo shpjegohet, së pari, nga aspekti gjeografik, pasi nuk bëhet fjalë për zhvendosje nga një gjeografi e caktuar në një tjetër më të largët, por brenda një rajoni ku ndërveprimet njerëzore dhe ekonomike kanë qenë të vazhdueshme; për më tepër, nga pikëpamja administrative, këto hapësira ishin të ndërlidhura me njëra-tjetrën si pjesë të Despotatit të Epirit.¹⁸ Në këtë këndvështrim, lëvizshmëria e njerëzve shfaqet si një proces i zakonshëm dhe i dokumentuar nga burimet,¹⁹ edhe pse më shumë evidentohen dyndjet që ndodhën gjatë shek. XIV.

Kështu, një emigrim i konsiderueshëm i shqiptarëve, ndonëse nuk kemi të dhëna të sakta mbi numrin e tyre, shfaqet edhe gjatë shek. XIV, ku një pjesë e madhe e popullsisë u vendos kryesisht në Thesali, si pasojë e pushtimeve të Stefan Dushanit në hapësirat veriore të banuara nga shqiptarët. Ky realitet historik tanimë nuk ka nevojë për argumente të mëtejshme, pasi procesi i emigrimit të popullsisë shqiptare drejt hapësirave territoriale që sot i përkasin Greqisë është qartësisht i dokumentuar.²⁰ Megjithatë, ajo që mbetet për t'u sqaruar lidhet me

¹⁸ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. I (Ilirët, Mesjeta, Shqipëria nën Perandorinë Osmane gjatë shek. XVI – vitet 20 të shek. XIX), redaktor shkencor Kristaq Prifti, grup autorësh, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2002, 321-232; Pëllumb Xhufi, *Árbërit e Jonit. Vlora, Delvina e Janina në shek. XV-XVII*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë (Tiranë: Onufri, 2016), 34-37.

¹⁹ Sipas Raçës, dokumentet flasin për shtegtime të ngjashme që datojnë në vitet 1021-1022, pra në fillimet e shek. XI. Shih: Shkëlzen Raça, *Shtegtimet dhe ngulimet e shqiptarëve në Greqi, shek. XIII-XIV* (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 2004), 38.

²⁰ Për një trajtesë të qasjes së historiografive greke e shqiptare rreth çështjes së emigrimit të popullsisë shqiptare drejt hapësirave jugore gjatë shek. XIV, shih: Kostantinos Giakoumis, "Fourteenth-century Albanian migration and the 'relative

aspekte të tjera të kësaj zhvendosjeje. Fjala vjen, rreth numrit të popullsisë që mërgoi, është e rëndësishme të kuptohet nëse ata qëndruan në këto territore edhe në shekujt e mëvonshëm, apo u zhvendosën nga kjo gjeografi, pra nga hapësirat ku u vendosën fillimisht. Të gjitha këto çështje mbeten ende të pazbardhura nga studimet e kryera deri më sot.

Gjithashtu, lidhur me vendosjen e kësaj popullsie që migroi, mënyrën e organizimit të saj, marrëdhëniet me popullsinë përreth dhe proceset historike që ajo përjetoi gjatë shekujve të mëvonshëm, studimet mbeten ende në një fazë sipërfaqësore. Ato përqendrohen kryesisht në zonat ku u vendos kjo popullsi ose në rastet ku ajo përmendet në burimet e kohës, të cilat fokusohen në zhvillimet politiko-ushtarake në këto hapësira. Më konkretisht, bëhet fjalë për prishjet e rendit, trazirat politike, raportet me Venedikun dhe, më pas, rezistencën ndaj inkursioneve osmane. Dokumente të kohës, si Kronika e Janinës, ajo e Tokove, si dhe tekstet e Halkokondilit dhe historianëve të tjerë të shek. XV, na japin të dhëna mbi ngjarjet e këtushme dhe rastet kur shqiptarët dalin në skenë, si popullsi e kësaj gjeografie ose si aktorë politiko-ushtarakë.²¹ Tekstet në fjalë janë analizuar dhe shfrytëzuar prej dekadash nga historianë të ndryshëm që janë marrë me këtë temë; prandaj nuk është e nevojshme t'i rishikojmë edhe njëherë këtu.

Ajo që vlen të theksohet, në këndvështrimin tonë, lidhet me një konstatim të Halil İnalcık-ut mbi popullsinë që emigroi pas vitit 1330 nga vende të ndryshme të Shqipërisë së sotme drejt hapësirave jugore. Sipas historianit osman, këta banorë mund të evidentohen lehtësisht për faktin se ishin organizuar në bashkësi komunitare të quajtura *katun/e*.²² Kështu, sipas İnalcık-ut, në vitin 1467 vetëm në Livadhja kishte 24 *katunde* shqiptare, ndërsa në nahijen Istifa 34 të tilla.²³

autochthony' of the Albanians in Epeiros. The case of Gjirokastrë", *Byzantine and Modern Greek Studies*, no. 27 (2003): 172-174; Gjithashtu, shih: Jahja Drançolli, "Diaspora shqiptare në Greqi gjatë shek. XV", *Studime historike*, nr. 3-4 (1987): 149-167.

²¹ Në lidhje me tekstet në fjalë, shih: *Burime tregimtare bizantine për historinë e Shqipërisë, shek. X-XV*, përgatitën Koço Bozhori, Filip Liço (Tiranë: Akademia e Shkencave e RPSH, Instituti i Historisë. 1975); Teresa Shawcross, *The Chronicle of Morea. Historiography in Crusader Greece* (Oxford: Oxford University Press, 2009).

²² Për më shumë të dhëna, shih: Halil İnalcık, *Fatih Devri Üzerinde Tetkikler ve Vesikalar*, I (Ankara: Türk Tarih Kurumu Basımevi, 1954), 146.

²³ Këto *katune* kishin një status të veçantë që i dallonte nga fshatrat e regjistruara në regjistrat kadastrorë të hapësirës së Thesalisë në shek. XV. Për më shumë detaje, shih: İnalcık, *Fatih Devri Üzerinde Tetkikler*, 146.

Në fakt, kjo e dhënë na vë përballë një tjetër elementi të rëndësishëm: nëse popullsia që emigroi në këtë periudhë ishte vendosur kryesisht në fshatra dhe zona homogjene të emërtuara *katune*, atëherë si duhet të konsiderohet pjesa tjetër e popullsisë me përkatësi etnike shqiptare, e cila gjendet në këto hapësira dhe dokumentohet në regjistrat kadastrorë të kësaj periudhe?

Para se të trajtojmë informacionin që na ofrojnë regjistrat e taksave në fjalë, fillimisht le të shohim se si paraqitej situata politike në këto hapësira gjatë kohës së mësymjeve osmane drejt kësaj gjeografie.

Hapësirat jugore dhe juglindore gjatë fazës së parë të inkursioneve osmane

Prezenca e ushtrive osmane në hapësirën e Epirit filloi të intensifikohet fill pas betejës së Maricës në vitin 1371,²⁴ duke ndërmarrë ekspedita të vazhdueshme drejt këtyre hapësirave, të cilat rrezikuan seriozisht zotërimet e fisnikërisë lokale. Kështu, gjatë viteve 1380, osmanët sulmuan tokat e Zenebishëve, ndërsa më 1385 pushtuan qytetin e Kosturit, i cili ishte pjesë e zotërimeve të familjes së njohur shqiptare të Muzakajve.²⁵ Sikurse dihet, pika e kthesës që vulosi qëndrimin përfundimtar të osmanëve në hapësirën ballkanike ishte Beteja e Kosovës në vitin 1389. Pas kësaj, siç shihet edhe nga regjistrat kadastrorë osmanë të fillimit të shek. XV, sundimi i sulltanit në këto hapësira ka konsistuar përmes nënshtrimit të fisnikëve vendës, një proces që praktikisht funksiononte në suazat e vasalitetit ndaj sulltanit.²⁶

²⁴ Për një shpjegim të detajuar të inkursioneve osmane dhe vendosjes së tyre në zonën e Thesalisë, shih: Delilbaşı, *İki İmparatorluk Tek Coğrafya*, 315-317; Delilbaşı, *History of Preveza in the XVth Century*, 53.

²⁵ Athanas Gegaj, *Shqipëria dhe invazioni turk në shekullin XV*, përktheu Qemal Velija (Tiranë: Zenit Editions, 2025), 62; *Historia e Popullit Shqiptar*, I, 377; *Defteri i regjistrimit të Përmetit dhe Korçës*, 12-13.

²⁶ Për metodat osmane të pushtimit gjatë kësaj periudhe dhe raportet e vasalitetit të aplikuar në hapësirën ballkanike, shih: Halil İnalçık, "Ottoman Methods of Conquest", *Studia Islamica*, no. 2 (1954): 103-105. Vendosja e sundimit osman në këto hapësira del në pah përmes ndarjeve të timareve që i përkasin kësaj periudhe, e cila përkon me sundimin e Bajezidit I dhe bijve të tij. Ky sistem vazhdoi të ekzistonte edhe pas vdekjes së sulltanit të lartpërmendur në vitin 1402, ngjarje që i futi bijtë e tij në rivalitet për pushtet. Kjo epokë njihet në historinë osmane edhe si koha e vakuimit të pushtetit (*Fetret Devri*). Për më shumë, shih: Fahameddin Başar, "Fetret Devri", *TDV İslam Ansiklopedisi*, C. XII (İstanbul: TDV Yay., 1995), 480-482; Dimitris J.

Defteri më i hershëm osman për këtë hapësirë periferike të Rumelisë osmane, ose Ballkanit, është ai i sanxhakut të Arvanidit, i vitit 1431. Kjo njësi administrative, që shtrihej nga brigjet e lumit Mat dhe vijonte drejt Shqipërisë së Mesme dhe Jugore, kishte për qendër Gjirokastrën dhe zgjatej deri në Vageneti, hapësirë që përkon me zonën e Thesprotisë. Në këtë gjeografi, që përfshinte Gjirokastrën, rrethinat e saj dhe territoret më në Jug, në kapërcyell të shek. XV sundonte familja e madhe shqiptare e Zenebishëve. Kështu, në vitet 1400, Gjini Zenebishi përmendet si sundimtar i Vagenetisë, Pargës, Sajadhës dhe Parakala (mo) së.²⁷

Pasi lëmë pas hapësirat juglindore, si Korçën, Përmetin dhe Kosturin, ku qeverisnin Muzakajt,²⁸ si edhe ato jugore, si Gjirokastra me Vagenetinë, ku sundonin Zenebishët, mund të depërtojmë edhe më thellë në brendësi, ku elementi shqiptar shfaqet sërish si faktor politik e ushtarak me zotërimet e veta. Më konkretisht, nga regjistri i Tërhallës mësojmë se pinjollëve të Pavlo Kurtikut u ishin shpërndarë timare në këtë sanxhak. Fjala është për Ibrahimin dhe Jusufin, bijtë e Isa Beut, ky i fundit djali i fisnikut të lartpërmendur.²⁹

Burimet historike dëshmojnë qartë se, gjatë periudhës së inkursioneve osmane drejt hapësirave të Thesalisë dhe veçanërisht Moresë, shqiptarët përbënin faktorin kryesor lokal që iu kundërvu një pushtimi të mundshëm të këtyre zonave. Një dukuri jonatyrale nëse ata do të ishin një komunitet i ardhur apo minor në raport me numrin e popullsisë. Kështu, nëse u referohemi të dhënave që përcjell Halkokondili, gjatë mësymjeve të ushtrive osmane nën komandën e Turahan Beut drejt Moresë në vitin 1423, periudhë që përkon me sundimin e Muradit II, rezistenca kryesore u organizua nga shqiptarët, të cilët ishin mbledhur në Davia dhe morën vendimin për të qëndruar

Kastritsis, *The Sons of Bayezid. Empire Building and Representation in the Ottoman Civil War of 1402-1413* (Leiden: E. J. Brill, 2007), 25-26.

²⁷ Regjistri i sanxhakut Arvanid, XIII; Drançolli, *Diaspora shqiptare*, 155.

²⁸ Në vitin 1441 vërehet se zonat e Përmetit dhe të Gjirokastrës u ishin ndarë si feude sërish një pinjollit të Muzakajve, përkatësisht Jakup Bej Muzakës. Ky ishte i biri i Teodor II Muzakës dhe në vitin e lartpërmendur mbante postin e drejtuesit (sanxhakbeut) të sanxhakut të Arvanidit. Për më shumë, shih: *Fatih Devri Üzerinde Tetkikler*, 159; Paolo Petta, *Despotë të Epirit e princër të Maqedonisë. Mërgata shqiptare në Italinë e periudhës së Rilindjes*, përktheu Pëllumb Xhufi (Tiranë: Botimet IDK, 2000), 138-139.

²⁹ *Defter-i Sancak-ı Tirhala*, C. I, IX-X.

përballë forcave armike.³⁰ Është e rëndësishme të theksohet se faktori shqiptar në hapësirat jugore dhe juglindore gjatë periudhës së inkursioneve osmane nuk shfaqej vetëm si një element sundues, por edhe si një prani e gjerë, e organizuar vetë dhe e gatshme për të luftuar kundër osmanëve, pavarësisht popullsisë greke, sipas autorëve të kohës.³¹

Sipas İnalçık-ut, Gjini Zenebishi vdiq në vitin 1418 si një vasal i sulltanit,³² aspekt i cili na lë të kuptojmë se periudha e vasalitetit në këtë hapësirë zgjati mbi tri dekada. Ky detaj ka rëndësi të veçantë, pasi lidhet drejtpërdrejt me fazat e pushtimit osman të këtyre zonave, gjë që ndikoi edhe në raportet që vetë ata patën me fisnikërinë dhe popullatën vendëse. Gjatë kësaj periudhe të hershme, pra kohës së vasalitetit, fisnikët ruajtën pozitat e tyre edhe nën sundimin e sulltanit, me kushtin që të përmbushnin disa detyrime ndaj tij. Pikërisht për këtë arsye, veçanërisht në defterin e Arvanidit, vërejmë se territore të caktuara janë emërtuar në emër të fisnikut vendës që i sundonte ato. Kështu, midis vilajeteve të shumta të përfshira në regjistrin e lartpërmendur veçohet ajo e Pavlo Kurtikut,³³ i cili, siç dallohet edhe nga emri, ishte i krishterë, ndërsa një pjesë e pasardhësve u myslimanizuan dhe morën poste në shtetin osman. Një vilajet tjetër në këtë regjistër është ai i Gjirokastres, ku hartuesi i defterit ka shënuar se kjo zonë njihej gjithashtu si zotërim i Zenebishëve.³⁴

Vendosja e sundimit osman në dy periudha – fillimisht përmes vasalitetit dhe më vonë përmes pushtimit, ky i fundit si rrjedhojë e kryengritjeve në rajon – është tejet e rëndësishme për të kuptuar faktorin lokal, i cili deri atëherë kishte “bashkëjetuar” me osmanët në kushtet e vasalitetit, ndërsa më pas iu nënshtrua sundimit të tyre në kuadër të pushtimit. Thënë ndryshe, faktori sundues shqiptar në hapësirat jugore dhe juglindore, në vijën Korçë-Përmet-Gjirokastër e më poshtë, ekzistonte përpara ardhjes së osmanëve, qëndroi nën ta në rrethanat e

³⁰ Për më shumë detaje, shih: Marios Philippides, *Constantine XI Dragaş Palaeologus (1404-1453). The Last Emperor of Byzantium* (New York: Routledge, 2019), 87-89.

³¹ “The Albanians of the Peloponnesus [= Morea] gathered in the inland region called Davia, elected their own general, and made plans to secede from the Hellenes in order to destroy the army of Turahan.” Shih: Philippides, *Constantine XI Dragaş Palaeologus*, 88.

³² İnalçık, *Fatih Devri Üzerinde Tetkikler*, 159.

³³ *Regjistri i sanxhakut të Arvanidit*, 166.

³⁴ “Vilayet-i Aryurikasri, nam-i diger Vilayet-i Zenebishi”. Shih: *Regjistri i sanxhakut të Arvanidit*, 2; İnalçık, *Fatih Devri Üzerinde Tetkikler*, 159.

vasalitetit dhe iu nënshtrua sundimit osman pas pushtimit të këtyre zonave në vitet '30 të shek. XV.

Parë në një kuadër më të gjerë, periudha e vasalitetit ka rëndësi të veçantë për studiuesin, pasi gjatë kësaj kohe nuk vërehen thyerje të mëdha në aspektin ushtarak dhe demografik, siç do të ndodhte në dekadat pasuese. Nëse në aspektin administrativ kjo periudhë shënon kalimin nga një sistem politik të një tjetër, në kontekstin e “fotografimit” të gjendjes ekonomike, demografike e madje edhe etnike, kjo epokë tranzicioni ka rëndësi, pasi nuk ekzistojnë censuse të tipit të regjistrave kadastrorë për sundimet e mëparshme.³⁵ Për këtë arsye, kryerja e krahasimeve bëhet e vështirë për lexuesin, i cili detyrohet të mbështetet kryesisht te kronikat e kohës.

Njëri prej problemeve që studiuesit kanë evidentuar lidhur me defterët e kësaj periudhe ka të bëjë me ndarjen administrative të sanxhaqeve, nahijeve dhe regjistrimeve, e cila shpesh duket “kaotike”.³⁶ Mirëpo, një tablo e tillë nuk lidhet me aspektin administrativ që zbatuan osmanët, por me fleksibilitetin që ata treguan në ndërtimin e sistemit. Në zonat ku rendi nuk ishte vendosur plotësisht, osmanët hezitonin të krijonin një njësi administrative. Rasti më konkret është ai i Elbasanit, i cili fillimisht varej nga Ohri dhe u bë qendër sanxhaku vetëm pasi u thye rezistenca shqiptare dhe osmanët konsoliduan pushtetin e tyre.

Mbi praninë e shqiptarëve në hapësirat e përfshira brenda regjistrat kadastror për sanxhakun e Tërhallës të vitit 1454-1455

Meqenëse nga regjistrat që përmendëm më lart, ai për hapësirat e Tërhallës pozicionohet gjeografikisht më në Jug, por është gjithashtu i llojit *mufassal*, që nënkupton se përmban edhe emrat e banorëve, këtu do të ndalemi vetëm tek të dhënat e këtij defteri për të shqyrtuar çështjen e identifikimit etnik në burimet historike të këtij lloji.

³⁵ Një rast i regjistrimeve të periudhës paraosmane për hapësirën shqiptare është vetëm kadastra dhe koncesionet veneciane të Shkodrës për vitet 1416-1417. Ndërsa për zonat e tjera, burimet e këtij lloji mungojnë, gjë që e vështirëson ndjeshëm analizën e ndryshimeve që përjetoi kjo hapësirë ndërmjet dy sundimeve të ndryshme.

³⁶ Një vlerësim i tillë është bërë për atë pjesë të Thesprotisë që administrativisht bënte pjesë në sanxhakun e Arvanidit. Për më shumë, shih: E. Balta, M. Oğuz, F. Yaşar, *The Ethnic and Religious Composition of Ottoman Thesprotia*, 347-348.

Nisur nga fakti se regjistrat osmanë të kohës nuk e cilësojnë elementin etnik, lind natyrshëm pyetja si mund të evidentohet etnia e popullsisë së regjistruar. Një pjesë e individëve identifikohet relativisht lehtë, pasi si shtesë të emrit përdornin termat *Arnavud* (në rastin e myslimanëve) dhe *Arvanidis* (kur personi i përket besimit ortodoks), elemente që tregojnë qartësisht përkatësinë etnike të individit. Megjithatë, nëse qatipi që ka hartuar regjistrin nuk e ka shënuar emërtimin *Arvanid* apo *Arvanidis*, dallimi i përkatësisë bëhet i pamundur. Për ta ilustruar këtë, mjafton të marrim si shembull një nga fshatrat e shumta të defterit të Tërhallës, Konskon, ku nga 60 kryefamiljarët e regjistruar, vetëm gjashtë janë identifikuar me mbiemrin *Arvanidis*. Praktikisht, për pjesën tjetër të banorëve nuk mund të nxirret ndonjë përfundim, pasi emrat e tyre nuk përmbajnë ndonjë element që të mundësojë dallimin. Fjala vjen, nëse emrat Janis apo Andrijas që hasen në defter nuk do të kishin mbiemrin *Arvanidis*, do të ishte e pamundur t'i evidentosh si shqiptarë.³⁷

Në këtë rast, problemi me të cilin përballlet studiuesi kur tenton të interpretojë përbërjen etnike të popullsisë së përfshirë në regjistrat kadastrorë lidhet me metodologjinë e leximit të burimeve, duke marrë parasysh elementet historike dhe onomastike. Një qasje të tillë e gjejmë të zbatuar nga Selami Pulaha për pjesën veriore të hapësirave shqiptare, konkretisht në defterin e hollësishëm të sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485,³⁸ i cili i përket të njëjtit shekull dhe lidhet ngushtë me të njëjtat problematika.

Sipas autorit në fjalë, i cili merr si rast studimor zonat që bënin pjesë në defterin e lartpërmendur, në një hapësirë ku popullatat kanë qenë vazhdimisht në kontakt të drejtpërdrejtë dhe në ndërveprim me njëra-tjetrën, elementet e toponimisë dhe antroponimisë mund të ndihmojnë pjesërisht në shtjellimin e çështjes. Kjo për vetë faktin se, ashtu si në hapësirën veriore, ku elementi sllav kishte funksionuar si një entitet politik – pra shtetëror – dhe kulturor, nëse i referohemi gjuhës së shkruar dhe asaj kishtarë,³⁹ edhe në zonat jugore elementi grek kishte shërbyer si identitet dominues, jo vetëm në aspektin politik, por edhe në atë

³⁷ (بائس ارواندس) *Defter-i Sancak-ı Tirhala*, C. II, fl. 30a-30b.

³⁸ *Defteri i regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485*, përgatiti Selami Pulaha, ribotim, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë (Tiranë: Botimet albanologjike, 2018).

³⁹ Për tezën në fjalë, shih *po aty*, 32.

linguistik duke pasur parasysh përdorimin e gjuhës greke në Bizant. Në një panoramë të tillë, fakti që shqiptarët nuk patën një entitet të tyre politik, për shkak të ndarjes fetare, e cila nuk u mundësoi një gjuhë të përbashkët kishtarë si të grekët apo sllavët dhe se hapësirat e banuara prej tyre ishin vazhdimisht nën sundimin e fuqive të huaja, tregon qartë se, si në aspektin politik ashtu edhe në atë kulturor, ata ndodheshin në një pozicion më inferior se fqinjët. Kjo është edhe arsyeja pse një pjesë të konsiderueshme të vendbanimeve të shqiptarëve i hasim në burimet historike me emërtime që reflektojnë gjurmët e sundimeve mbi këto vende.

Për ta ilustruar këtë, mjafton të përmendim fshatin Gur i Bardhë, i cili sot bën pjesë administrativisht në rrethin e Matit. Në burimet latine ai haset si *Petralba*, një vend ku ndodhet edhe kështjella me të njëjtin emër, e përmendur gjerësisht gjatë epokës së Skënderbeut.⁴⁰ Ndërkaq, në regjistrin e parë osman për zonat e Dibrës të vitit 1467, ku figuron edhe ky fshat, emri i tij shënohet si *Bilakamin*, një toponim me origjinë sllave.⁴¹ Në dokumentacionin e periudhës osmane ai njihet si *Akkaya*, ndërsa pas Pavarësisë përdoret emërtimi *Gur i Bardhë*. Pra, kemi katër emërtime të ndryshme për të njëjtin vend, që nxjerrin në pah katër sundime apo epoka të ndryshme.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për emrat e njerëzve, të cilët në pjesën më të madhe i hasim me domethënie religjioze. Kur flasim për shek. XV, këta emra janë kryesisht katolikë ose ortodoksë, me rit sllav në Veri dhe me rit grek në Jug. Në një kontekst të tillë, kur elementi shqiptar ishte kulturalisht më inferior se të lartpërmendurit, emërtime të tilla që shpjegohen përmes gjuhës shqipe, veçanërisht emrat vetjakë, hasen në një masë më të kufizuar. Në këtë pikë, Pulaha bën një ndarje prej tre brezash ose rrahësh, përmes të cilave mund të evidentojmë popullsinë shqiptare që jetonte në atë kohë në një hapësirë të caktuar. Kështu, në brezin e parë përfshihen vendbanimet ku popullsia shqiptare është në shumicë; në brezin e dytë, raporti midis popullsisë është pothuajse i barabartë; ndërsa në brezin e tretë, emrat e fshatrave, vendbanimeve dhe banorëve me

⁴⁰ Marin Barleti, *Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut*, përktheu Stefan I. Prifti (Tiranë: Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, 1967), 80-81.

⁴¹ *Defteri i hollësishëm për zonat e Dibrës i vitit 1467*, përktheu Vexhi Buharaja, përgatiti për botim Eduart Caka, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë (Tiranë: Botimet albanologjike, 2019), 7.

origjinë shqiptare janë shumë të paktë. Sipas Pulahës, këtu duhet përlogaritur edhe vija maksimale e kufijve ku shtrihet popullsia shqiptare, për arsye se këta banorë, pavarësisht numrit të vogël, arritën t'i rezistonin asimilimit dhe të ruanin gjallë elementet e tyre kulturore e etnike, të cilat dalin në pah nëpërmjet onomastikës.⁴²

Nëse do të shqyrtojmë hollësisht defterin e Tërhallës, vërejmë se teza e parashtruar nga Pulaha mbart një vërtetësi që dallohet qartësisht. Shumica e emrave të regjistruar përfundojnë me prapashtesën *-is*, si p.sh. Janis, Nikollas, Istefanos etj. Edhe kur emri është tipik shqiptar, si Bardhi, ai shfaqet me prapashtesën *-is*, pra *Bardhis*, ose *Ginis* për Gjin dhe *Martinis*⁴³ për Martin.⁴⁴ Madje, diçka e ngjashme vërehet edhe kur përmendet elementi etnik, për shembull në formën *Arvanid-is*. Ky aspekt ka rëndësi, pasi nxjerr në pah superioritetin kulturor, ku ndonëse individit me origjinë shqiptare ruante identitetin e tij, në kontekstin shoqëror ai i përshtatej realitetit duke e adaptuar emrin e vet. Sigurisht, një praktikë e tillë nuk vërehet vetëm te shqiptarët, por edhe te grupet e tjera etnike që jetonin në këto hapësira, si p.sh. vllehtë.

Emrat e lartpërmendur, të cilët dallohen qartësisht për përkatësinë e tyre shqiptare, ndonëse hasen më rrallë në fshatrat e sanxhakut të Tërhallës, shfaqen sërish në mënyrë të shpërndarë, zakonisht një ose dy në fshatra të caktuara. Ndërkohë, në pjesët më veriore të zonave të Tërhallës, emra të tillë si Martin, Gjin, Bardh etj. gjenden më shpesh. Ky fenomen shihet edhe në zonën e Dropullit, sipas leximit të pjesës përkatëse të defterit osman të Vlorës së vitit 1520, të përkthyer dhe prezantuar nga Ferit Duka.⁴⁵

Një element tjetër që vlen të theksohet sërish mbi të njëjtën tezë lidhet me përdorimin e termave identifikues *Arvanidis*, *Arvanid*, *Arnavud*, të cilët hasen në emrat e zotëruesve të timareve ose të banorëve të regjistruar në defterët osmanë. Edhe pse regjistrat për sanxhakun e Arvanidit, si dhe ata të Përmetit dhe Korçës janë të llojit *mufassal*, pra përmbledhës dhe që e bëjnë të pamundur leximin e emrave të banorëve,

⁴² Sigurisht, Pulaha e konkretizon tezën e tij duke dhënë si shembull zonat dhe vendbanimet e përfshira në regjistrin e sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485. Për më shumë detaje, shih *Defteri i regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës*, 33-34.

⁴³ استقالنوس کنس në fshatin Kaloyirohori. Për më shumë, shih *Defter-i Sancak-ı Tirhala*, C. II, fl. 21a.

⁴⁴ مارتنس ازواندس në fshatin Kalapodi. Shih *po aty*, fl. 27a.

⁴⁵ Duka, "Realiteti etnik i Dropullit", 167-168.

emërtimet *Arvanid* ose *Arnavud*, që u referohen shqiptarëve, hasen shumë rrallë. Më konkretisht, edhe në ato raste kur janë përdorur, u referohen atyre timariotëve shqiptarë që ishin islamizuar.⁴⁶ Ndërsa në defterin e Tërhallës, shembuj të tillë hasen shumë më shpesh. Kjo, sipas këndvështrimit tonë, nënkupton faktin se nevoja për t'u identifikuar në këto zona ishte më e madhe.

Praninë e popullatës shqiptare e gjejmë të shtrirë edhe në ato fshatra që zyrtarët osmanë i emërtuan sipas etnive të tjera. Një shembull i tillë është fshati *Çuka Eflagan*, i cili lidhet me vllëhtë, ku ndër emrat e banorëve të këtij vendbanimi hasim edhe emrin Progonis Arvanidis (برو غونس اروانيدس).⁴⁷

Krahas *katune-ve* që përmendëm më lart, në regjistër hasim edhe fshatra të emërtuara si me shqiptare, siç vërehet në rastin e *Karje-i Çuka Arnavudan*, i cili kishte gjithsej 47 shtëpi, 5 vejusha dhe 7 beqarë.⁴⁸ Ekzistojnë gjithashtu raste si ai i fshatit Vilë, i cili, sipas shënimit përkatës, banohej nga shqiptarë që nuk ishin regjistruar më herët dhe që më pas iu nënshtruan Turhan Beut, duke u përfshirë në dokumente si raja dhe taksapagues.⁴⁹

Një shpërndarje e tillë nuk vërehet vetëm në hapësirat rurale, pra fshatrat, por edhe në ato urbane. Më konkretisht, njëra prej lagjeve të Tërhallës ishte ajo e shqiptarëve (Mahalle-i Arnavudan).⁵⁰ Ndonëse të gjithë të krishterë, këta shqiptarë nuk ishin të grupuar vetëm në një lagje, por i gjejmë të pranishëm edhe në lagjet e tjera të qytetit. Për shembull, në lagjen e tretë (Mahalle-i Thalithe) hasim emrat Dimas Arvanidis, Miços Arvanidis dhe Gurkas Arvanidis,⁵¹ ndërsa në lagjen e pestë

⁴⁶ Fjala vjen, në defterin e vitit 1431-1432 për zonat e Përmetit dhe të Korçës hasim vetëm një rast: ai i Arnavut Doganit, të birit të Ostojos, i cili shërbente si rojë në kalanë e Korçës dhe zotëronte një timar. Shih: *Defteri i regjistrimit të Përmetit dhe Korçës*, 93. Edhe në regjistrin për sanxhakun e Arvanidit, që i përket së njëjtës periudhë, por përfshin një hapësirë gjeografike shumë më të madhe, rastet e timariotëve me mbiemrin Arnavud, pra shqiptarë, janë vetëm dy: Arnavud Jusuf në fshatin Ardasovë dhe Arnavud Hamza në fshatin Istrelë. Për këto raste, shih *Regjistri i sanxhakut të Arvanidit*, 7, 55.

⁴⁷ *Defter-i Sancak-ı Tirhala*, C. II, fl. 21a.

⁴⁸ Për më shumë hollësi, shih *po aty*, fl. 33b.

⁴⁹ Në lidhje me rastin në fjalë, shih *po aty*, fl. 159a.

⁵⁰ Këtu të tërheqin vëmendjen emra si Bardhi, Gjini, Gjiniakis, Sulis, Beratis etj. shih *po aty*, fl. 7b.

⁵¹ *Po aty*, fl. 6a.

(Mahalle-i Hamise), ku dallohen qartë edhe vllehtë, vërejmë edhe emrat e të vesë së Nikolla Arvanidit dhe të Jorgis Arvanidit.⁵²

Krahas popullsisë së krishterë, në regjistër hasim edhe banorë shqiptarë të qytetit, të cilët janë shënuar si myslimanë. Nuk mund të thuhet nëse këta ishin të ardhur apo banorë vendës të konvertuar, pasi defteri nuk jep ndonjë shpjegim për këtë çështje. Megjithatë, në aspektin religjioz, nga shënimet në regjistër konstatohet se ka pasur një proces islamizimi, ndoshta të kufizuar në numër.⁵³ Kështu, në lagjen “Birgi” hasim emrin e Dogan Arnavudit, ndërsa pesë rreshta më poshtë përmendet Jusufi, i biri i Arnavud Doganit.⁵⁴ Me shumë gjasa, ata ishin babë e bir dhe bënin pjesë në esnafët e lagjes, pasi pjesa dërrmuese e banorëve ushtronte profesione si nallban, samarxhi, këpucar, argjendar etj.

Një kategori tjetër e popullsisë shqiptare në këto zona përbëhej edhe nga ata që bënin pjesë në kastën sunduese, pra zotëronin timare. Përveç dy nipërve të Pavlo Kurtikut, Jusufit dhe Ibrahimit, që zotëronin feude, në regjistër hasim edhe shqiptarë të tjerë të konvertuar në besimin islam, të cilët shërbenin si ushtarakë dhe zotëronin timare. Për shembull, Sulejmani dhe vëllai i tij Iljazi, sipas shënimeve në defter, ishin shqiptarë dhe zotëronin një timar.⁵⁵

Në këtë sanxhak hasim edhe një numër të krishterësh me origjinë shqiptare që zotëronin timare, çka tregon se ata bënin pjesë në klasën ushtarake. Për shembull, Bardhi me Teodorin, bij të Gjonit, kishin një timar të tyrin.⁵⁶ Një timar tjetër i përkiste Gaziut dhe Nikollas, ky i fundit bir i Bardhit.⁵⁷ Po ashtu, edhe Muriqi dhe Gjini zotëronin një timar që përfshinte fshatra të varura nga Jenishehri (Larisa), i cili, sipas shënimeve në regjistër, u ishte ndarë atyre që nga kohët e hershme.⁵⁸

⁵² *Po aty*, fl. 7a.

⁵³ Për shembull, në lagjen “Xhami” (Mahalle-i Xhami) përmendet një person me emrin Sulejman, dhe më tej shpjegohet se ai ishte konvertuar nga hebre në mysliman. Shih: *po aty*, fl. 2a.

⁵⁴ *Po aty*, fl. 3b-4a.

⁵⁵ *Po aty*, fl. 346a.

⁵⁶ *Po aty*, fl. 450a.

⁵⁷ *Po aty*, fl. 183b.

⁵⁸ *Po aty*, fl. 101b.

Përfundime

Regjistrat kadastrorë osmanë luajtën një rol të rëndësishëm, veçanërisht në aspektet ekonomike dhe demografike të perandorisë, sidomos gjatë shek. XV, kur osmanët u vendosën në Ballkan, por edhe në shekullin pasues, që shënoi edhe konsolidimin e tyre në këtë gjeografi. Parë në aspektin e historiografive lokale në periudhën postimperiale, rëndësia e këtyre burimeve rritet edhe më shumë, pasi studiuesit sot i përdorin këto dokumente në studime më të thelluara dhe në fusha të palëvruara më herët. Edhe pse historianët shqiptarë kanë arritur të botojnë disa nga këta regjistra, pjesa më e madhe e tyre mbetet ende e pashfrytëzuar.

Sikurse u përpoqëm ta paraqesim edhe në këtë artikull, studimet demografike të bazuara në regjistrat kadastrorë jo vetëm që japin përgjigje për pyetje që historiografia ka ngritur prej kohësh, por ndihmojnë gjithashtu të evidentohen disa të vërteta mbi debate të karakterit historik, të cilat, fatkeqësisht, me kalimin e kohës janë kthyer në diskutime politike, duke dalë përtej kornizave shkencore.

Bibliografi:

- ALEXANDER, John C. "Counting the Grains: Conceptual and Methodological Issues in Reading the Ottoman Mufassal Tahrir Defters". *Arab Historical review for Ottoman Studies*, no. 19-20 (1999): 55-69.
- BALTA, Evangelia & Oğuz, Mustafa & Yaşar, Filiz. "The Ethnic and Religious Composition of Ottoman Thesprotia in the Fifteenth to Seventeenth Centuries". *Thesprotia Expedition II; Environment and Settlement Patterns*. Ed. Björn Forsén, Esko Tikkala. Helsinki: Suomen Ateenan-Instituutin Säätiö, 2011.
- BARLETI, Marin. *Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut*. Përktheu Stefan I. Prifti. Tiranë: Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, 1967.
- BAŞAR, Fahameddin. "Fetret Devri", *TDV İslam Ansiklopedisi*, C. XII, İstanbul: TDV Yay., 1995, fq. 480-482.
- Burime tregimtare bizantine për historinë e Shqipërisë, shek. X-XV*. Përgatitën Koço Bozhori, Filip Liço. Tiranë: Akademia e Shkencave e RPSH, Instituti i Historisë, 1975.

- CAKA, Eduart. "Regjistri kadastral i Përmetit dhe i Korçës si burim të dhënash mbi gjendjen e Shqipërisë Juglindore në gjysmën e parë të shek. XV", *Studime historike*, nr. 1-2 (2018): 55-71.
- Defteri i hollësishëm për zonat e Dibrës i vitit 1467*. Përktheu Vexhi Buharaja, përgatiti për botim Eduart Caka. Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë. Tiranë: Botimet albanologjike, 2019.
- Defteri i regjistrimit të Përmetit dhe Korçës i vitit 1431*. Përktheu Vexhi Buharaja, përgatiti për botim Eduart Caka. Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë. 2018.
- Defteri i regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485*. Përgatiti Selami Pulaha, ribotim. Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë. Tiranë: Botimet albanologjike, 2018.
- DELILBAŞI, Melek. "A Contribution to the History of Epirus (XVth-XVIth Centuries)", *GAMER*, vol. I, no. 1 (2012): 37-60.
- DELILBAŞI, Melek. "History of Preveza in the XVth Century According to the Ottoman Taxation Registers", *OTAM*, vol. 2, no. 2 (1991): 53-61.
- DELILBAŞI, Melek. *İki İmparatorluk Tek Coğrafya: Bizans'tan Osmanlı'ya Geçişin Anadolu ve Balkanlar'daki İzleri*. İstanbul: İthaki, 2013.
- Dokumente për historinë e Shqipërisë të shekullit XV*, vëll. III (1411-1415). Transkriptimi dhe përkthimi nga Injac Zamputi, Përparime Huta. Redaktimi dhe përgatitja për botim nga Edmond Malaj. Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë. Tiranë: Botimet albanologjike, 2018.
- DRANÇOLLI, Jahja. "Diaspora shqiptare në Greqi gjatë shek. XV". *Studime historike*, nr. 3-4 (1987): 149-167.
- DUKA, Ferit. "Realiteti etnik i Dropullit në burimet historike të shek. XVI. (Defteri osman i regjistrimit të pronave dhe të popullsisë të sanxhakut të Vlorës i vitit 1520)". *Studime historike*, nr. 3-4 (1991): 167-199.
- GEGAJ, Athanas. *Shqipëria dhe invazioni turk në shekullin XV*. Përktheu Qemal Velija. Tiranë: Zenit Editions, 2025.
- GELLNER, Ernest. *Nacionalizmi*. Përktheu Bashkim Shehu. Tiranë: Botimet IDK, 2008.
- GIAKOUMIS, Kostantinos. "Fourteenth-century Albanian migration and the 'relative autochthony' of the Albanians in Epeiros. The case of Gjirokastrë". *Byzantine and Modern Greek Studies*, no. 27 (2003): 171-183.
- Hicri 835 Tarihli Sûret-i defter-i sancak-i Arvanid*, Neşr. Halil İnalçık. Ankara: Türk Tarih Kurumu Basımevi, 1954.

- Hicrî 859 Tarihli Sûret-i Defter-i Sancak-ı Tırhala*, C. I-II. Neşr. Melek Delilbaşı, Muzaffer Arıkan. Ankara: Türk Tarih Kurumu Basımevi, 2001.
- Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. I (Ilrët, Mesjeta, Shqipëria nën Perandorinë Osmane gjatë shek. XVI – vitet 20 të shek. XIX), redaktor shkencor Kristaq Prifti, grup autorësh, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2002.
- İNALCIK, Halil. “Ottoman Methods of Conquest”, *Studia Islamica*, no. 2 (1954): 103-129.
- İNALCIK, Halil, *Fatih Devri Üzerinde Tetkikler ve Vesikalar*, I. Ankara: Türk Tarih Kurumu Basımevi, 1954.
- KASTRITSIS, Dimitris J. *The Sons of Bayezid. Empire Building and Representation in the Ottoman Civil War of 1402-1413*. Leiden: E. J. Brill, 2007.
- KIEL, Machiel. “Central Greece in the Suleymanic Age. Preliminary Notes on Population Growth, Economic Expansion and its Influence on the Spread of Greek Christian Culture”, *Soliman le Magnifique et Son Temps. Acts du Colloque de Paris*. Ed. Gilles Veinstein. Paris: La Documentation Française, 1992.
- LOWRY, Heath W. *Studies in Defterology: Ottoman Society in the Fifteenth and Sixteenth Centuries*. Istanbul: The Isis Press, 1992.
- ORTAYLI, İlber. “Millet: Osmanlılar’da Millet Sistemi”. *TDV İslam Ansiklopedisi*, C. XXX. Ankara: TDV Yay., 2020.
- PETTA, Paolo. *Despotë të Epirit e Princër të Maqedonisë. Mërgata shqiptare në Italinë e periudhës së Rilindjes*. Përktheu Pëllumb Xhufi. Tiranë: Botimet IDK, 2000.
- PHILIPPIDES, Marios. *Constantine XI Dragaş Palaeologus (1404-1453), The Last Emperor of Byzantium*. New York: Routledge, 2019.
- RAÇA, Shkëlzen. *Shtegtimet dhe ngulimet e shqiptarëve në Greqi, shek. XIII-XIV*. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 2004.
- Regjistri i Sanxhakut të Arvanidit i vitit 1431*. Përgatitur për botim nga Halil Inalcık. Përkthyer nga Mykerem Janina. Përkthimi i hyrjes dhe përgatitja për botim në shqip nga Eduart Caka. Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë. Tiranë: Kristalina-KH, 2017.
- SCHMITT, Oliver Jens. *Arbëria Venedike, 1392-1479*. Përkthyer nga Ardian Klosi. Tiranë: Fjala Publishing, 2014.
- SHAWCROSS, Teresa. *The Chronicle of Morea. Historiography in Crusader Greece*. Oxford: Oxford University Press, 2009.
- SHUFLAJ, Milan. *Qytetet dhe Kështjellat e Shqipërisë, Kryesisht në Mesjetë*. Përgatiti për botim Luan Malltezi. Tiranë: Onufri, 2009.

- URSINUS, M. O. H. *The Encyclopaedia of Islam, New Edition*. Ed. C. E. Bosworth, E. Van Donzel, W. P. Heinrichs, Ch. Pellat, vol. VII. Leiden: E. J. Brill, 1993.
- XHUFI, Pëllumb. *Árbërit e Jonit. Vlora, Delvina e Janina në shek. XV-XVII*. Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë. Tiranë: Onufri, 2016.

DR. EDUART CAKA

Institute of History / Academy of Sciences of Albania
edicaka@hotmail.com

S u m m a r y

ON THE ETHNIC-RELIGIOUS COMPOSITION OF SOUTHERN ALBANIAN
AREAS DURING THE 15TH CENTURY ACCORDING TO OTTOMAN CADASTRAL
REGISTERS OF THIS PERIOD. A RE-READING

The extension of the Ottoman rule in the Balkans during the 15th century also brought with it changes in the political, economic and cultural aspects of this area. Thus, apart from a small part of the coastal areas that still remained under the Venetian rule, the sultan's rule was fully extended to the interior of the peninsula, which in practical terms we find implemented mainly through the installation of the timar system. Consequently, the cadastral registers (Tahrir Defterleri), which are also the main sources that refer to the functioning of this system, also constitute the primary documentation regarding the history of the Ottoman possessions for this century. Although the purpose of their compilation is directly related to the fiscal policies that the Ottomans undertook in those areas where they extended their rule, the cadastral registers are the main sources for understanding local history when talking about the 15th century. In this article, we aim to read these sources in order to highlight the role they play in tracing the presence of the Albanians especially in the southern regions during this period.

Keywords: Demography, ethnicity, religion, ottoman cadastral registers, 15th century.